

STATUT
I SHOQERISE "MSE-Energy" .

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MSE-Energy", eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga ortaket e saj bazuar- ne Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare"

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 20.02.2023, Ne, themeluesit, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **MSE Energy**.

Themeluesi i vetem i shoqerise eshte: Resmie Dhana mbajtes i kartes se identitetit me nr F455150750, i datelindjes 15/05/1954 dhe banues ne Kucove.

Neni 2:

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem :

Te zhvilloje veprimtari ne punimet e ndertimit per objekte civile, industriale, turistike etj; Te zhvilloje veprimtari ne punimet e germimit te dheut, punimet e muratures dhe beton arme; Te zhvilloje veprimtari ne punimet e mirembajtjes; Te zhvilloje veprimtari ne punimet e restaurimit; Te zhvilloje veprimtari ne prodhimin, tregtimin, import - eksport te materialeve te ndertimit, makineri e pajisje; Te zhvilloje veprimtari ne prodhimin e materialeve inerte, materialeve me baze bitumi; Te zhvilloje veprimtari ne ndertime civile dhe ekonomike, ndertim rruges; Te zhvilloje veprimtari ne ndertimet hekurudhore, ndertime ura dhe vepra arti, ndertime detare, ndertime hidraulike e hidroteknike, vepra te vecanta e punime speciale; Te zhvilloje veprimtari ne projektimin e ndertimeve civile; Te zhvilloje veprimtari ne transportin e mallrave me mjete jashte norme; Te zhvilloje veprimtari ne fushen e bujqesise, blegtorise dhe pemtarise; Te zhvilloje veprimtari perpunimi paraprak dhe perfundimtar te produkteve te ndryshme bujqesore, blegtorale dhe f'utore; Te zhvilloje veprimtari ne import - eksport, blerje/shitje me shumice dhe pakice, te produkteve bujqesore, blegtorale, f'utore, lendeve kimike e materialeve ndihmese lidhur drejteperdrejte me veprimtarine kryesore; Te zhvilloje veprimtari ne ndertimin e linjave te energjise elektrike dhe nenstacionet elektrike T.L/T.M/f.U; Te zhvilloje veprimtari ne ndertimin e linjave te telekomunikacionit; Te zhvilloje veprimtari ne ndertimin e impianteve te energjise se rinovueshme; Te zhvilloje veprimtari ne fushen e mirembajtjes, remontit profilaktik te mesem e kapital te transformatoreve te llojeve te ndryshem; Te zhvilloje veprimtari ne fushen e ndertimit per punime ndertimi, sherbime mirembajtje e riparim te aseteve te infrastruktures energjitike industriale te TL dhe TM, punime hidraulike, elektrike, punime hekuri dhe cdo punim tjetër qe ka te beje me ndertime e montime; Te zhvilloje veprimtari ekonomike ne fushen e import-eksportit dhe tregtimin me shumice e pakice te makinerive e pajisjeve elektrike dhe elektronike per perdorim industrial. Te zhvilloje veprimtari si operator tatimor ;Te zhvilloje veprimtari per grumbullimin, transportimin e mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme (inerteve);Te zhvilloje veprimtari ne fushen e hoteleri-turizmit, strukturave akomoduese hoteleri, bar, delivery, katering, fast food, restorant me plan sherbim te personalizuar, shazllone, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, piste ne det me lokacion bar restorant, vendbazim per mjete ujore, motorrike dhe jo motorrike, sherbime opsionale plotesuese me karakter clodhje, pushimi apo defrimi, spektakli, lojra, organizime dhe realizime "eventesh" te ndryshme, sherbim Spa, sherbim parkimi, ofrimi i guidave turistike si dhe cdo veprimtari tjetër ekonomike qe dote konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per vijimin e aktivitetit te shoqerise; Te zhvilloje veprimtari ne prodhimin dhe tregtimin e pijeve alkolike dhe



jo alkolike; Te zhvilloje veprimtari ne fushen e pastrimit te mjediseve urbane, punime ne siperfaqe te gjelberta, sherbime dekorative, dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim; Te zhvilloje veprimtari ne menaxhimin e integruar te mbetjeve urbane, grumbullim, magazinim, seleksionim dhe ruajtje te mbetjeve. Te zhvilloje veprimtari te mirembajtjes, larjes, dezinfektimit dhe riparimit te konteniereve te mbetjeve urbane dhe industriale; Shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo operacion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues.

Shitje me shumice dhe pakice montim panele fotovoltaike, impiante fotovoltaike, eolike dhe cdo impianti te energjise se rinovueshme. Import, eksport te artikujve te ndryshem. Shit-blerje online te artikujve te ndryshem, sherbime online, montime dhe riparime te paneleve diellore. Agjenci udhetimi, ndermjetesim te cdo lloji ne fushen tregtare, akomodimi me qera, shitblerje pasuri te paluajtshme, shitblerje automjetesh, makina me qera.

Import eksport, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice te: Energjise Elektrike, hidrikarbureve gazit natyror, pajisje elektrike dhe aparatura elektronike, produkte, mallra dhe lende te para te perdorimit industrial dhe te pergjithshem, makineri, pajisje per perdorim industrial dhe te pergjithshem, mobilje, pajisje zyre dhe mjete informatike. Aktivitete konsulence dhe projektimi inxhinjerik. Aktivitet i prodhimi dhe tregtimit, importit dhe eksportit te ferro-kromit dhe ferro-aliazheve. Cdo aktivitet tjeter qe perputhet me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe qe konsiderohet nga shoqeria me perfitim dhe i dobishem per arritjen e objektivave te saj kryesore.

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një kohë të pacaktuar.

Neni 4:

Selia

(1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Kuçovë, Lagjja 1 Maj, Rruga Kristaq Laçka, ND:38 H:1

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :

Email - energymse@gmail.com

Tel-0688334909

Kreu II **Kapitali**

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1,000 Lekë, dhe i ndarë në 1 (një) kuotë.

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Resmie Dhana: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 1,000 lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.



Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Administratori i shoqerise dote caktohet **Resmie Dhana**. Afati i emerimit, eshte 2 vjet, duke filluar nga data 20/02/2023 deri me 20/02/2025.

Neni 14

Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- c) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic; parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posac;me me rendesi te vec;ante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere mete lalte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje Oltak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec; sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:



1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjeter dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i



detyruar që t'ja paraqese e dorezoje në kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Për deklaratimet mujore në tatime ose/dhe bashki do të caktohet një ekonomist/e i punësuar me pagë ose person fizik/shoqëri tregëtare e cila ushtron aktivitet mbajtje llogarie dhe shërbim biznesi kundrejt faturimit të shërbimit.

Kreu V

Prishja -riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) në vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) në hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregëtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) në vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim në shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtesë" Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregëtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 990 I datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare."

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria dote zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

OR TAKU

I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TË KUFIZUAR

*** MSE-Energy ***

Resmë Dhana

